

“Shpresë për ty” dhe studimeve biblike që drejtohen nga ata që i vizitojnë në Shqipëri, Angola, Kamboxhia, Republikën demokratike të Kongos, Etiopi, Gana, Indonezi, Bregun e Fildishtë, Kore, Liberi, Nepal, Paraguaj, Afrikën e Jugut, Tanzani dhe Tajlandë.

24. Për mbështetjen financiare të vazhduar të programeve “Shpresë për ty” nga ERF në Gjermani, Zvicër dhe Austri; NOREA në Danimarkë, Norvegji dhe Suedi; Messengers në Finlandë; partnerët e TWR në Azi, Brazil, Kanada, Hollandë/Belgjikë dhe Mbretërinë e Bashkuar; dhe Fondacionin Burnham.

25. Që faqja arabe e facebook “Shpresë për ty” (Laki Raja) ka arritur mbi 64 000 vetë dhe që skuadrat marrin me qindra emaille nga më shumë se 10 vende që flasin arabisht. Lutuni që kjo lidhje të sjellë shpresë tek gratë arabe dhe fruta që zgjasin për mbretërinë e Perëndisë.

26. Për radiot; Cd-të që përmbajnë programet “Shpresë për ty”, kalendarët e lutjes, dhe skriptet e programit “Shpresë për ty”; Biblat dhe litaraturat që përgatiten dhe shpërndahen.

27. Që mijëra dëgjues të programit “Shpresë për ty” kanë ndarë dëshmitë për mënyrën si programi i ka ndihmuar ata të kuptojnë të merren me zemërimin, të rrisin fëmijë të shëndetshëm, t’i trajtojnë bashkëshortët më mirë dhe të jetojnë jetë që nderon Perëndinë.

28. Që drejtuesit e komunitetit dhe media janë të ekspozuar ndaj përdhunimeve, abuzimeve me fëmijët, trafikimit dhe praktikave kulturore të dëmshme.

29. Që Zoti ka siguruar dashuri me bollëk dhe shërim për Celina Rempel pas operacionit në syrin e saj. Falenderoni Zotin që Susie Pek dhe të tjerët morën më shumë përgjegjësi në mënyrë që shërbesa në Brazil të mund të vazhdonte.

30. Për zonjat e Projektit Ana që kanë siguruar radio, ushqim, rroba, kujdes shëndetsor dhe pagesën e shkollës për jetimët dhe vejushat. Lavdëroni Zotin për gratë koreane dhe burrat që kanë udhëtuar në Vietnam dhe kanë siguruar shumë gjëra për të rritur shërbesën e Projektit Ana atje.

Zoti po ndryshon jetë.

Besimtarët në një fshat të vogël me 33 familje në Lindjen e Mesme, shumica e të cilëve kanë ardhur tek Krishti përmes programeve “Shpresë për ty” takohen javë për javë. Ata dëgjojnë programin, studiojnë Biblën, adhurojnë dhe lutën sëbashku. Në një vend tjetër, disa gra refugjate jetojnë bashkë në një apartament që është marrë me qera nga një grup lutjeje i Projektit Ana që përbëhet nga gra afgane, gjermane, irakiene, iraniane, siriane, suedeze dhe turke. Grupet e lutjes në kampet e refugjatëve, fshatrat e izoluar apo zona të vafëra takohen për të adhuruar bashkë sepse nuk ka kishë në zonën e tyre.

Gratë që rrihen apo braktisen nga burrat e tyre, apo që trajtohen si skllave nga familja e burrave të tyre kanë gjetur shpëtimin përmes Jezus Krishtit. Ato kanë gjetur forcë për t’ia dalë mbanë cdo dite me ndihmën e programeve “Shpresë për ty” dhe grupeve të lutjes së Projektit Ana. Disa madje ia kanë dorëzuar jetën Krishtit duke e ditur që anëtarët e familjes mund t’i vrasin për këtë.

Bashkëshortë, etër, kryetarë fshatrash, pastorë, të burgosur dhe burra të tjerë kanë dëshmuar që program “Shpresë për ty” i ka ndihmuar të përballen me problemet e përditshme dhe i ka ndihmuar të jenë burra më të mirë në familjet dhe komunitetet e tyre. Komunitetet i kanë kërkuar grupeve të Projektit Ana t’u mësojnë zanate të ndryshme të varfërve dhe të burgosurve.

Zoti po transformon qendrimin e zemrave të grave rreth e rrotull botës. Ndërsa ato e lejojnë Frymën e Shenjtë t’i fuqizojë ato, ato ngrenë zërin për ata që janë të keqtrajtuar. Ato ndajnë atë pak që kanë, me ata që vuajnë.

Të gjitha këto gjëra bëhen në emrin e Zotit dhe përmes fuqisë së lutjes. Lavdëroni dhe falenderoni Zotin tonë të fuqishëm!

“Do të kremtoj midis popujve, o Zot do të këndoj lavdet e tua midis kombeve, sepse e madhe deri në qiell është mirësia jote dhe e vërteta jote arrin deri në re. U lartofsh mbi qiejt o Perëndi; lavdia jote shkëqeftë mbi të gjithë tokën.” (Psalmi 57:9-11)

Nëse dëshironi, mund t’i dërgoni kërkesat tuaja të lutjes në adresat:
Kutia postare 130 Tiranë, ose në: valetungjillit@yahoo.com



*Të lavdërojmë dhe
falenderojmë Perëndinë*

Nëntor 2015

Qëndroni me ne në Radio 7:

Kalendari i lutjes -- cdo ditë ora 7:15/22:00

Shpresë për ty - të shtunë/ të dielë ora 8:30/ 15:30



Falenderoni dhe lavdëroni...

1. Që gratë rreth e rrotull botës po lavdërojnë Zotin me jetën e tyre edhe atëherë kur rrethanat e vështira nuk ndryshojnë për mirë. Një dëgjues në Nepal dëshmon: *“Jam pa shkollë. S’mund të lexoj Biblën. Jam i aftë vetëm të dëgjoj për të kuptuar Fjalën e Zotit. Programi “Shpresë për ty” më ndihmon të kuptoj gjërat për Zotin Jezus Krisht dhe se si ai ka siguruar shpëtimin me dashurinë e tij të madhe. Kur dëgjoj programin “Shpresë për ty” unë ndiej lumturi dhe gëzim në jetën time. Shumica e grave në Rana Tharu janë pa shkollë. Faleminderit shumë për këtë program që na ndihmon të ndërtojmë jetën shpirtërore.”*

2. Që programi “Shpresë për ty” i Projektit Ana dëgjohet në 69 gjuhë në radio, internet, CD dhe në pajisje të tjera. Lavdëroni Zotin që ka filluar transmetimi në gjuhën Pashto dhe është plotësisht i siguruar.

3. Që Campus Crusade for Christ dhe TWR/Projekti Ana kanë përfunduar versionin audio në anglisht të filmit Magdalena “Përmes syve të saj” dhe programit radiofonik “Portrete shprese” të bazuar në materialin e studimit të Biblës Magdalena, që është thjeshtësuar për t’u përkthyer. Lutuni që këto programe do të dishepullizojnë dhe do t’u sjellin shpresë grave në shumë vende në të ardhmen. Lutuni për fondet e nevojshme dhe skuadrat kombëtare të prodhimit për versionin në gjuhën arabe dhe hindu.

4. Për përfundimin e radiodramave “Zëri shërues” (për viktimat e fistulave) në gjuhën Ari dhe për shpërndarjen e saj në Etiopi. Ju lutemi vazhdoni të luteni për prodhimin në gjuhët amaraike dhe oromo.

5. Skuadrën profesionale që regjistroi versionin në anglisht të radiodramës “Thesare të fshehura” (për gratë e shfrytëzuara dhe trafikuar seksualisht në Evropë). Perëndia ka vazhduar të punojë edhe pse ka pasur shumë sfida.

6. Që e vërteta dhe dashuria e Zotit të shpallen nga radio në Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut, Azinë Qendrore dhe vende të tjera ku të krishterët përndiqen dhe misionarët nuk lejohen të hyjnë. Jetët po ndryshohen dhe kishat po formohen. Vazhdoni të luteni për gratë që abuzohen nga burrat apo anëtarë të tjerë të famijes, vetëm për shkak se janë të krishtera.

7. Që në një fshat të vogël me 33 familje në Lindjen e Mesme, 22 prej tyre janë besimtare, shumica e kanë pranuar Krishtin pasi kanë dëgjuar programin “Shpresë për ty”

çdo javë ato mblidhen dhe dëgjojnë programin, e luten e adhurojnë së bashku. Ato kanë 4 grupe grash që studiojnë Biblën dhe 4 Bibla.

8. Për refugjatët që flasin gjuhën farsi dhe që kanë pranuar Krishtin si Shpëtimtarin e tyre dhe po dishepullizohen nga skuadra e prodhimit në gjuhën farsi. Lutuni për dëgjuesit dhe ndërmjetësuesit që takohen për të inkurajuar njëri tjetrin në ecjen me Zotin.

9. Për 18-vjetorin e shërbesës së Projektit Ana që arrin gratë përmes ndërgjegjësimit, lutjes dhe programeve radiofonike. Lavdëroni Zotin për ndërmjetësuesit që i janë bashkuar sezonit 40-ditor të lutjes dhe agjërimit dhe që me besnikëri janë lutur për kërkesat e lutjes të muajit. “Shikoni midis kombeve dhe këqymri, do të mbeteni të habitur dhe të shastisur, sepse unë do të kryej në ditët tuaja një vepër, që ju nuk do ta besoni edhe sikur t’jua tregonin” (Habakuku 1:5)

10. Për zgjerimin e shërbesës së lutjes së Projektit Ana veçanërisht në Shqipëri, Afrikën Qendrore, Etiopi, Bregun e Fildishtë, Kenia, Mianmar, Irlandën e Veriut, Afrikën e Jugut, Tanzani, Tajlandë dhe Lindjen e Mesme.

11. Për ata qëndra vullnetarë dhe staf të Projektit Ana në cdo kontinent – producent programi, koordinator shërbesash, anëtarë skuadrash, ndërmjetësues, teknikë radioje, autorë skriptesh, grupe lutje dhe ata që vizitojnë apo u shkruajnë dëgjuesve.

12. Për faqet e internetit të Projektit Ana, aplikacionet në telefon, faqet e facebook-ut, si edhe për TWR360, të gjitha këto aftësojnë shumë vetë të shkarkojnë programin “Shpresë për ty” dhe kalendarin e lutjes në gjuhën e përdoruesve. Me mijëra vetë kanë raportuar se ata janë mirënjohës që dikush kujdeset, i dëgjon dhe lutet për ta.

13. Që gratë që kanë marrë trajnime profesionale në Brazil, Indi, Indonezi, Paraguaj, Tanzani dhe shumë vende të tjera në mënyrë që ato të sigurojnë financiarisht për familjet e tyre.

14. Për sigurinë dhe prezencën e Zotit gjatë mijëra miljeve të udhëtimit të Marlit në Afrikë, Evropë, Azinë Qendrore dhe Jugore, dhe Amerikën e Veriut duke i shërbyer ndërmjetësuesve dhe dëgjuesve të Projektit Ana, duke mentoruar skuadrat, duke ndarë shpresën dhe shpëtimin dhe duke inkurajuar kishat të vazhdojnë të përmbushin Fjalët e Urta 31:8: “Hape gojën tënde në favor të memecit, në mbrojtje të të gjithë atyre që janë lënë pas dore...”

15. Që shumë refugjatë të rinj po kërkojnë miqësi dhe një vend të sigurt në shtëpitë Ana në Suedi dhe në grupet e lutjes në vende të tjera. Lutuni për ata që do të kërkojnë Zotin dhe të kuptojnë se ai kujdeset për ta dhe i fton ata të pranojnë dhuratën e tij të shpëtimit përmes Jezus Krishtit.

16. Për ata mijëra njerëz të përfshirë në grupet e lutjes së Projektit Ana që takohen rregullisht për t’u lutur, për të arritur gratë dhe ungjillizuar në burgje, në maternitete, jetimore, spitale dhe qendra refugjatësh. Shumë prej tyre shpërndajnë ushqim, rroba dhe sende për bebe duke u dhënë shpresë grave dhe familjeve të tyre.

17. Që Yvone Knox iu përgjigj thirrjes së Zotit për të shërbyer si vullnetare e Projektit Ana në Irlandën e Veriut dhe që kishat janë përgjigjur me gëzim ndërsa janë ndarë nevojat e grave. Lutuni për zhvillimin e një programi radiofonik 15-minutësh që trajton çështjet e grave dhe vajzave të reja në Irlandë dhe Irlandën e Veriut, në Mbretërinë e Bashkuar dhe anë e mbanë botës.

18. Që 6000 kalendarë lutjeje të gushtit u shpërndanë me një set librash ungjillizimi për 5000 gra nga Thai dhe Laoticia.

19. Që Ann Seri iu përgjigj thirrjes së Zotit për të shërbyer vullnetarisht si koordinator e Projektit Ana për Afrikën Qendrore/Perëndimore. Gjithashtu edhe Brenda Lombard po ndihmon tani Ruth Mbennah në Afrikën e Jugut dhe atë Lindore, ku shërbesa ka marrë rritje të madhe.

20. Për gratë, burrat dhe kryetarët e fshatrave që janë bërë ndjekës të Krishtit përmes përpjekjeve ungjillizuese të Projektit Ana, që përbëhen nga programet radiofonike, vizitat e stafit që ndajnë dashurinë e Zotit me njerëzit, grupet e lutjes, konferencat dhe shërbesat e mëshirës.

21. Për ata që vullnetarisht përkthejnë kalendarin mujor të lutjes së Projektit Ana në mënyrë që të tjerët të mund të lutën me ne në më shumë se 85 gjuhë.

22. Për ata pastorë, bashkëshortë, dhe staf të TWR që mbështesin dhe u shërbejnë vullnetarëve dhe stafit të Projektit Ana anë e mbanë botës.

23. Që mijëra të burgosur kanë marrë shpresë përmes dashurisë së treguar në mënyrë praktike (si përmes dhuratave si veshje, sapunë dhe sende për bebe); përmes programit